




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK.nr. 516/2023**  
**Datë: 27 nëntor 2023**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 dhe 33 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 2 të Rregullores Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funkionimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, në takimin 317-të, të mbajtur më 27 nëntor 2023, merr këtë:

### **V E N D I M**

- I. Autorizohet Departamenti për Çështje Ligjore në SKGJK, për hartimin e memos informuese lidhur me ndryshimet e fundit të Ligjit për Procedurën Përmbaremore dhe rekomandimin e Asamblesë për lëndët përmbaremore ku gjykatat janë kreditor.
  
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

### **A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka shqyrtuar rekomandimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, nga takimi i datës 8 nëntor 2023, për caktimin e rasteve kur mund të konsiderohet se kërkesat janë të përfunduara për lëndët e fushës së përmbaremeve, ku gjykatat janë propozues për përmbaremore dhe sa i përket paushalleve gjyqësore.

Në Gjykatat e Republikës së Kosovës, ka një numër të konsiderueshëm të lëndëve të fushës së përmbaremeve, ku gjykatat janë propozues për përmbaremore dhe atë sa i përket paushallëve gjyqësore. Pothuajse në të gjitha gjykatat janë ndërmarrë veprime me qëllim të rritjes së produktivitetit dhe efikasitetit në trajtimin e lëndëve, përkatësisht në përmbaremin e tyre, mirëpo gjatë punës është vërejtur se në të shumtën e rasteve ka pengesa të cilat pamundësojnë ekzekutimin e këtyre paushallëve gjyqësore nga gjykatat.

Meqë Ligji për Procedurën Përmbaremore, ka pësuar ndryshime, lidhur me këtë çështje konsiderohet e nevojshme që Departamenti për Çështje Ligjore në SKGJK, të përgatit memo informuese për Këshillin, lidhur me ndryshimet e fundit të Ligjit NR. 08/L-102 për plotësim/ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për procedurën përmbaremore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.05/L-118 dhe ndërlidhjen më rekomandimin e Asamblesë për lëndët përmbaremore ku gjykatat janë kreditor.

Nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- *Departamenti për Çështje Ligjore në SKGJK;*
- *Sekretariatit të KGJK-së;*
- *Arkivit.*